



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

P.nr.547/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Selvije Kostërci, në lëndën penale ndaj të akuzuarit: I.M. nga ..., për shkak të veprës penale: Rrezikimi i trafikut publik, të parashikuar nga neni 378 par.8 lidhur me par. 6 e 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.261/2015 të datës 22.09.2017, të dorëzuar në gjykatë me datë 02.10.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 27.03.2019 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Stojanka Kasalovic dhe të pandehurit, me datë 29.03.2019 e shpalli publikisht, ndërsa me datë 15.04.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

I.M., nga i ati ... dhe e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me datë ... në fshatin ..., Komuna e ..., ku edhe tani jeton, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr personal ..., shqiptar, shtetas i Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

sepse,

Me datë 22.07.2014, rreth orës 15:30 në rrugën rajonale ..., konkretisht në ..., duke shkel ligjin mbi trafikun publik, vepron në kundërshtim me nenin 54 të Ligjit për sigurinë në komunikacion rrugor dhe nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, aq sa vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e markës dhe tipit “ Ford Connect”, ngjyrë e kuqe, me targa të regjistrimit ..., duke mos i përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe duke mos përshtatur këtë shpejtësi gjendjes dhe pjesëmarrësve tjerë ashtu që ditën kritike me të arritur në vendin e ngjarjes duke u kyçur nga rruga dytësore, duke mos u ndalur fare në shenjen e komunikacionit, e cila ishte vendosur në rrugë e që kishte kuptimin e ndaljes, apo ndryshe siç quhet, shenja “STOP”, del në shiritin e rrugës rajonale në drejtim të ..., e ku në atë moment nga drejtimi i ... qarkullonte automjeti i udhëtarëve i markës dhe tipit “Passat”, ngjyrë e bardhe, me targa të regjistrimit ..., të cilin e drejtonte i dëmtuari F.B., i cili në pamundësi që të ik aksidentit në shiritin e vet të lëvizjes me pjesën e përparme të automjetit ndeshet me automjetin “Ford Connect” të cilin e drejtonte i pandehuri I.M. në pjesën anësore të përparme të anës së djathtë e me këtë rast lëndime pasojnë: F.B. dhe atë ndrydhje të indeve të buta të krahavorit dhe gjurit të djathtë; Y.B. dhe atë plagë prerëse në regjionin e fytyrës; E.B. dhe atë ndrydhje në indet e buta të gjurit të majtë; N.S. dhe atë ndrydhje në indet e buta të krahavorit dhe gjurit të djathtë; I.B. dhe atë ndrydhje dhe gërvishtje në anën e majte të kokës, lëndime këto të konstatuara nga ekspertiza mjeko-ligjore si lëndime të lehta trupore, ndërsa i dëmtuari S.B. pëson lëndime dhe atë thyerje të kockës së krahut të djathtë, lëndime këto të konstatuara nga ekspertiza-ligjore si lëndime të rënda trupore sa i përket këtij të dëmtuari.

Me këtë ka kryer veprën penale: Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 e 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 23, 41, 42, 43, 45, 49, 50, 51, 52, 73, të KPRK-së, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, e:

G J Y K O N

1. Dënim me burgim të kushtëzuar në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në kohëzgjatje prej dy (2) vjetëve nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
2. Obligohet i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, dhe atë për ekspertizën e komunikacionit shumë prej 40.88€, për ekspertizën mjeko-ligjore shumë prej 50€, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumë prej 20€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
3. Të dëmtuarit: F.B., S.B., Nasrie Baliu, I.B., Y.B., dhe E.B., për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridik civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.261/2015 të datës 02.10.2017, kundër të akuzuarit I.M. nga ..., për shkak të veprës penale: Rrezikimi i trafikut publik neni 378 par.8 lidhur me par. 6 e 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ashtu që në këtë seancë i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, duke theksuar se e ndjej veten fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, është e vërtetë se atë ditë nuk kam qenë mirë me shëndet sepse isha tek mjeku në ambulante për ta kontrolluar tensionin e gjakut, dhe kam qenë duke dalur nga ambulanta dhe poashtu koha ka qenë shumë e nxehtë, të gjitha këto kanë ndikuar që të mos jem sa i duhet i kujdesshëm, unë kam kërkuar falje atëherë, edhe në polici e kam pranuar veprën, andaj e lus gjykatën që të merr parasysht rrethanat personale pasi që aktualisht jam i pa punë, kam tre fëmijë në shkollë, nënën e kam të sëmurë nga diabeti e që i vetmi që punon është babai si taksist.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se i pandehuri e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare, ky pranim është i bazuar në ligj dhe në pajtim edhe me provat materiale, gjendjen faktike, dhe atë pas njoftimit paraprakisht nga ana e gjykatës për favoret dhe disfavoret e pranimit të fajësisë, andaj i propozon gjykatës që ta pranojë pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe me rastin e shqiptimit të dënimit t'i merr parasysht të gjitha rrethanat lehtësuese.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Raporti policor i dt. 22.07.2014; Deklarata e të pandehurit dhënë në polici e dt. 23.07.2014; Deklaratat e të dëmtuarve I.B., N.S., Sabit Bliu, F.B., E.B., Y.B., të dhëna në polici me datë 25.07.2014; Raportet e Spitalit rajonal në Mitrovicë, për secilin të dëmtuar të datës 22.07.2014; Fletlëshimin e nga QKUK për të dëmtuarin S.P. nr.1432 dt. 25.07.2014; Mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr.D.H. i datës 30.01.2017; Mendimi dhe Konstatimi i ekspertit të komunikacionit rrugorë, Ing. S.B., i datës 18.01.2017; dhe fotodokumentacioni nga vendi i ngjarjes. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale që i vihen në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Rrezikimi i trafikut publik neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 e 1 të KPRK, e për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 të KPK-ës. Si rrethana rënduese ka gjetur intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e që kjo veprën penale ka qellim të mbrojtë jetën dhe trupin e individit, gjë që në rastin konkret është rrezikuar shëndeti i të dëmtuarit, ndërsa rrethana tjera rënduese nuk ka gjetur.

Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shprehur keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, gjendjen familjare dhe rrethanat familjare duke u nisur nga fakti se është mbajtës i familjes, po ashtu edhe i papunë dhe baba i tre fëmijëve në shkollim, çka për gjykatën nënkupton gjenden e vështirë ekonomike, sjellja korrekte e të pandehurit në gjykatë, faktin se nga shkresat rezulton se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, si dhe faktin se kjo veprën penale ka ndodhur në vitin 2014 dhe që nga atëherë ka kaluar një periudhë relativisht e gjatë, rreth 5 vite.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me burgim me kusht, ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par 1 të KPRK-së, që ti parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Poashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga veprimet e ndaluara në komunikacion.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.1 dhe 2.6 dhe nenit 453 par.1 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet për ekspertë dhe të paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitive të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr547/2017, dt.15.04.2019

Procesmbajtësja:
Selvije Kostërci

Gjyqtari

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.